


Shenjtori i ditës: Transferimi i lipsanit të Ignat Hyjmbajtësit - Dëshmorët Sarveli dhe Vivaja



E premte, 29 janar 2021 – Shenjtori i ditës.

DITË KRESHME

Transferimi i lipsanit të Ignat Hyjmbajtësit. Oshënarët Afrahati, Akepsimai. Dëshmorët Sarveli dhe Vivaja.

– Transferimi i lipsanit të Ignat Hyjmbajtësit –

Thonë për të se e mori Krishti në duart e tij të shenjta kur Ignati ishte akoma fëmijë i vogël dhe duke mësuar popullin e Jerusalemit, u thoshte: “Kush do të përulet si ky fëmijë i vogël, do të jetë më i madhi në Mbretërinë e Qiejve”. Duke thënë këtë, Krishti shfaqti qartë përparimin e ardhshëm të fëmijës në mësimin apostolik.

Shën Ignati u bë nxënës i ungjillorit Joan së bashku me Polikarpin e shenjtë, i cili u

bë episkop i Smirnës. I hirotonisur prift prej apostujve të shenjtë, ai u zgjodh prej tyre episkop i Antiokisë gjatë viteve 68-70 pas Krishtit dhe i mësuar nga ata përparonte në virtyt. Si një bari i mirë udhëhoqi për shumë vjet me devotshmëri bijtë e tij shpirtërorë.


Pas fitores mbi tartarët, Trajani nisi një luftë të egër kundër të krishterëve dhe i detyronte që t'i faleshin perëndive të tij, të cilët gjoja e ndihmuan që të fitonte në luftë. Ai urdhëroi që të gjithë të krishterët që s'pranonin t'i faleshin idhujve, të torturoheshin më parë e më pas të vriteshin. Në atë kohë Trajani, i cili ndodhej në Antioki për të filluar luftën kundër persëve, mësoi se Ignati predikonte besimin te Krishti.

Pas përpjekjeve dhe premtimeve të shumta për ta bindur që t'u falej idhujve, të cilat shkuan kot, Trajani urdhëroi që ta dërgonin në teatrin e Romës dhe kur të kishte panair të madh dhe të ishte i grumbulluar i gjithë populli, t'ia hidhnin bishave që ta shqyenin para të gjithëve.

Të krishterët e Romës u përpoqën që ta shpëtonin nga martirizimi, por shenjtë duke pasur dëshirë të zjarhtë që të martirizohej për Krishtin, i shkroi një letër atyre në të cilën u thoshte që të lejonin të bëhej dëshira e Perëndisë. E kështu urdhri i mbretit u zbatua.

Fjalët e fundit të shenjtë, para se ta shqyenin bishat ishin këto: “O spektatorë të dënimit tim, dua ta dini se nuk kam bërë asgjë të keqe që të dënohem me vdekje, por e pranoj me gëzim këtë dënim për t'iu afruar Perëndisë së vërtetë, të cilin e adhuroj”.

Pjesët e mbetura nga trupi i shenjtë, të krishterët i varrosën me nderim. E pikërisht në 29 janar Kisha jonë kremton transferimin e pjesëve të mbetura të lpsanit të shenjtë nga Roma për në Antioki.



* * * * *

– Dëshmorët Sarveli dhe Vivaja –

Sarveli ishte prift idhujtar në qytetin e Edhesës, në kohën e sundimit të Trajanit (rreth vitit 115). Një ditë, teksa përgatitej të kryesonte një festë pagane, i veshur me të gjitha stolitë e arta dhe gurët e çmuar, episkopi i shenjtë i qytetit, Varsimeu, i cili shumë herë i kishte bërë thirrje të braktiste kultin e idhujve, doli para tij dhe i shpalli borxhin e rëndë që kishte për të larë para Perëndisë për aq shumë shpirtra që i drejtonte në humbje. I prekur nga hiri i Krishtit, Sarveli e përfundoi celebrimin, por të nesërmen shkoi dhe e gjeti episkopin bashkë me të motrën e tij, Vivajën, i ra në këmbë dhe i kërkoi ta pagëzonte në atë çast. Lajmi i kthimit të priftit pagan e habiti qytetin dhe guvernatori Lisia e nxori menjëherë Sarvelin para gjyqit.

E torturuan dhe më pas e burgosën. Dy muaj më vonë i bënë tortura të reja, pasi e

morën edhe shumë herë në pyetje, pastaj e dënuan të sharrohej më dysh dhe ia prenë kokën. Gjatë asaj torture të tmerrshme martiri i shenjtë qëndroi i patundur, sikur shpirti i tij të gjendej në qiell. Pastaj, kur ia prenë kokën, e motra, e cila kishte marrë pjesë në ekzekutimin e tij, shtriu mbi trupin e shenjtit një shall, që të mblidhte gjakun, duke thënë: “U lidhtë shpirti im me tëndin pranë Krishtit, të Cilin e njoh dhe e besoj”. Kur njerëzit përreth i dëgjuan këto fjalë, shkuan e ia thanë guvernatorit, i cili dërgoi ushtarë t’ia prisnin kokën në vend edhe së motrës. Kështu, ajo e përzjeu gjakun e saj me atë të vëllait dhe u bashkua me korin e martirëve të shenjtë. Të krishterët erdhën dhe i mblodhën trupat e tyre dhe i varrosën në varrin e episkopit të shenjtë Abselam.

— facebook.com/koash1991